

VENDIM
Nr. 537, datë 25.9.2025

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE, ME SHKËMBIM
LETRASH, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCIVE, DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM, TË MARRËVESHJES SË GRANTIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE DHE
EKONOMISË, FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT DHE BANKËS
EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR PROGRAMIN E
MUNDËSIMIT TË TURIZMIT DHE INFRASTRUKTURËS, MIRATUAR ME
VENDIMIN NR. 883, DATË 12.11.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim letrash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, të marrëveshjes së grantit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për programin e mundësimit të turizmit dhe infrastrukturës, miratuar me vendimin nr. 883 datë 12.11.2020, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BORXHIT SHTETËROR

DREJTORIA E MARRËVESHJEVE DHE SIGURIMIT TË NDIHMËS SË HUAJ

Nr. 3822 Prot.

Tiranë, më 21 . 3 . 2024

Lënda: Marrëveshja e Grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për "Programin për Mundësimin e Turizmit dhe Infrastrukturës" miratuar me VKM. nr.883, datë 12.11.2020.

BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
Rruga "Abdi Toptani" Ndërtesa Drin, Kati 4, Tiranë

Të nderuar Zotërinj,

I referohem Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për "Programin për Mundësimin e Turizmit dhe Infrastrukturës". Me qëllim finalizimin e suksesshëm të aktiviteteve për t'u financuar nga kjo marrëveshje Granti, nëpërmjet kësaj shkrese ju përcjellim kërkesën e palës shqiptare si vijon:

-shtyrjen deri më 13.12.2027, të afatit të parashikuar sipas nenit 2.02 të Marrëveshjes së Grantit.

Kjo letër së bashku me letrën tuaj të përgjigjes do të përbëjnë marrëveshjen ndryshuese, me shkëmbim letrash të Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për "Programin për Mundësimin e Turizmit dhe Infrastrukturës.

Ky ndryshim hyn në fuqi, në datën e njoftimit të palës shqiptare për Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore.

MINISTËR I FINANCËVE



Shqipëri;

Web: www.financa.gov.al

Logo

Banka Evropiane
për Rindërtim dhe Zhvillim

Drejtuar: SH.T. Petrit Malaj
Ministër i Financave
Ministria e Financave, Blv. “Dëshmorët e Kombit” Nr. 1, Tiranë, Shqipëri

16 prill 2025

I nderuar Ministër Malaj,

Lënda: Projekti për Infrastrukturën dhe Turizmin në Shqipëri-data e Disponueshmërisë së Grantit

I referohemi shkresës së datës 21 mars 2024, me numër protokolli 3822, në lidhje me datën e disponueshmërisë të Marrëveshjes së Grantit, të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave numër 883, datë 12 nëntor 2020.

Kemi kënaqësinë t’iu informojmë se Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ka miratuar zgjatjen e Datës të Disponueshmërisë së Grantit, deri më 27 dhjetor 2027, në përputhje me dispozitat e Seksionit 2.02 (b) të Marrëveshjes së Grantit.

Dëshirojmë të përfitojmë nga rasti t’iu falënderojmë për bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme. Shprehim kënaqësinë për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dhe garantimin e zbatimit të suksesshëm të këtij projekti të rëndësishëm.

Me respekt,

/Nënshkrimi/

Ekaterina Solovova
Drejtuese e BERZH-it për Shqipërinë

Zyra Rezidente në Shqipëri, Rruga “Abdi Toptani” Torre Drin Kati i Katërt, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 2232 898; +355 4 2235 204 Faks: +355 4 2230580
